



KONSULTIME PUBLIKE SA PËR FORMALITET - MUNDËSUESIT, PASOJAT, ZGJIDHJET?

DHJETOR 2021



This Project is financed
by the European Union

Autorë: Megi Reçi and Diori Angjeli

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Një qasje transparente në proceset e konsultimit, përfshirëse ndaj shoqërisë civile dhe e hapur ndaj publikut, është me rëndësi të madhe për garantimin e integritetit, cilësisë dhe legjitimitetit të vendimmarrjes. Efektiviteti dhe vërtetësia e proceseve të tilla janë ngushtësisht të lidhura me transparencën që ofrohet nga institucionet përgjegjëse për vendimmarrjen.

Për të mundësuar kontroll nga publiku, qeveria duhet të sigurojë akses në proceset e konsultimit publik që në fazat e hershme të hartimit të ligjeve dhe politikave, përpara se projekt-aktet të shkojnë në Kuvend për miratim. Këshilli i Ministrave (në vazhdimësi "KM") është një aktor kyç në procese të tilla, pasi përgatit mesatarisht 80-85% të të gjitha projektligjeve që shqyrtohen çdo vit nga Kuvendi¹. Prandaj, në këtë dokument politikash do të trajtohen proceset e konsultimit publik në nivelin e qeverisjes qendrore, me synim evidentimin e faktorëve që mundësojnë anashkalimin e konsultimeve publike. Në dokument argumentohet se për të kryer procese të suksesshme dhe kuptimplota të konsultimit publik, duhet të adresohen mangësitë në kuadrin ligjor dhe në praktikën institucionale që mundësojnë anashkalimin e tyre. Së fundi, në këtë dokument ofrohen rekomandime politikash që synojnë eliminimin e mangësive ligjore të identifikuara dhe përmirësimin e transparencës proaktive.

KONTEKSTI

Në Shqipëri, pavarësisht se mekanizmat e konsultimit janë në fuqi, angazhimi qytetar ka pësuar rënie që nga viti 2016², ndërkohë që pjesëmarrja në konsultimet publike si një nga mjetet kryesore për angazhim qytetar, mbetet në nivele të pakënaqshme. Arsyet e qytetarëve për pjesëmarrje të ulët janë mosbesimi, përshtypja se nuk ka mekanizma konsultimi, mungesa e informacionit, etj.³ Ndërsa nga këndvështrimi i shoqërisë civile, ndër arsyet që mbizotërojnë janë mungesa e besimit se kontributi i dhënë do të merret parasysh, mungesa e njoftimeve apo njoftimet selektive.⁴

Sipas Komisionit të BE-së, konsultimet në Shqipëri janë shpesh ushtrime artificiale, ndërkohë që studimet e pavarura tregojnë se proceset e konsultimit publik karakterizohen kryesisht nga paqëndrueshmëria⁵, mungesa e transparencës dhe e përfshirjes dhe kultura e të bërit "sa për formalitet"⁶. Praktika të tilla janë ndër faktorët që ndikojnë negativisht tek besimi i publikut dhe angazhimi qytetar në vend. Ndër faktorët e ndryshëm dekurajues, ky dokument politikash fokusohet në mangësitë e kuadrin ligjor dhe praktikën jotransparente në lidhje me konsultimet publike, si dhe shqyrton ndikimin e tyre në anashkalimin e konsultimeve publike.

Mangësitë në kuadrin ligjor dhe dispozitat e paqarta ose të përgjithshme mund të keqinterpretohen për të anashkaluar proceset e konsultimeve publike ose të lejojnë që procesi të jetë artificial dhe i paefektshëm.

ÇFARË E MUNDËSON ANASHKALIMIN E PROCESIVE TË KONSULTIMIT PUBLIK?

E drejta për konsultim publik në nivel qeverisjeje qendrore në Shqipëri rregullohet nga Ligji "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", aktet nënligjore përkatëse, si dhe akte të tjera rregullatore. Pavarësisht se ligji është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, janë vënë re mangësi në përvojën gjashtëvjeçare të zbatimit të

tij. Më poshtë do të identifikohen dhe analizohen mangësitë në kuadrin ligjor, të kombinuara me praktikatat institucionale jotransparente të cilat shkaktojnë shmangien e proceseve të konsultimit publik në nivel qeverisjeje qendrore.

Ligji Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

Ligji nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" zbatohet për projektligjet, projekt-aktet strategjike kombëtare dhe vendore si dhe për politikatat me interes të lartë publik, ndërkohë që vendimet e Këshillit të Ministrave nuk përfshihen shprehimisht në objektin e këtij ligji. Ligji parashikon një gamë të gjerë përjashtimesh nga objekti i tij, si çështjet e sigurisë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, aktet administrative individuale, aktet administrative me karakter normativ, aktet normative me fuqinë e ligjit të miratuara nga KM, emergjencat civile, dhe çështje të tjera përjashtimore të përcaktuara me ligje të tjera. Megjithatë, ligji nuk ofron një listë të rasteve në të cilat organizimi i konsultimeve publike është i detyrueshëm. Ky boshllëk ligjor mundëson anashkalimin e procesit të konsultimit për çështje që mund të keqinterpretohen si çështje me interes të ulët publik dhe nuk garanton llogaridhënie në lidhje me mënyrën se si vlerësohet interesi publik në secilin rast. Një boshllëk tjetër i evidentuar në ligj ka të bëjë me faktin se si ky i fundit nuk përcakton rastet kur konsultimet paraprake (para se të hartohet dokumenti) janë të nevojshme, duke përcaktuar se ato zhvillohen në raste të veçanta dhe kur shihet e nevojshme, duke e lënë vendimin në dorë të institucionit publik dhe duke krijuar kështu hapësirë për subjektivizëm.

Publikimi i projektligjeve dhe politikave në regjistrin elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike është i detyrueshëm. Megjithatë, përdorimi i metodave të tjera të konsultimit (më të thjeshta në përdorim dhe më të aksesueshme) si takimet dhe dëgjesat publike, komunikimi nëpërmjet mjeteve elektronike, etj., është në dorë të vetë institucionit publik. Ligji parashikon që mund të përdoren forma të tjera njoftimi kur konsiderohet e nevojshme nga institucioni publik, pa përcaktuar se si vlerësohet nevoja dhe pa kërkuar të merren parasysh, p.sh., tregues të rëndësishëm si grupi i synuar. Për më tepër, organizimi i takimeve publike vendoset nga institucioni, bazuar në gjykimin e tij për rëndësinë e dokumentit dhe nivelin e interesit publik që ai mund të gjenerojë. Koncepte të tilla të gjera mund të keqinterpretohen në dëm të pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultimet publike.

Mekanizmat e paefektshëm të ankimit dekurajojnë shoqërinë civile dhe publikun e gjerë për përdorimin e mjeteve të tilla në rastet kur ndodhin shkelje në procesin e konsultimit publik.

Me qëllim sigurimin e llogaridhënies, institucioneve u kërkohet të japin përgjigje për rekomandimet dhe komentet e marra gjatë procesit të konsultimit publik. Megjithatë, ligji nuk parashikon një afat brenda të cilit duhet të jepet kjo përgjigje. Instrumenti i dhënies së përgjigjeve mbi kontributin e marrë nga OShC-të është shumë i rëndësishëm për të vlerësuar rolin e këtyre aktorëve në procesin e konsultimit publik. Megjithatë, OShC-ve shpesh nuk u jepet përgjigje për rekomandimet dhe komentet e tyre⁷ dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre mendojnë se institucionet e pranojnë kontributin e tyre të dhënë gjatë konsultimeve⁸. Mungesa e afateve dhe e përcaktimit të qartë të detyrimeve mund të jenë ndër shkaqet për vonesën ose mungesën e dhënies së përgjigjeve nga institucionet pas përfundimit të konsultimeve.

Ligji përcakton se ministri përgjegjës për Ligjin "Për njoftimin dhe konsultimin publik" është ministri që mbulon fushën e teknologjisë dhe informacionit, pa përcaktuar më tej rolin e këtij institucioni. Megjithatë, VKM-ja që rregullon funksionimin e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike i ngarkon këtij ministri përgjegjësinë për të drejtuar procesin e krijimit, funksionimit, administrimit dhe monitorimit të regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike ishte përgjegjës deri në vitin 2017 kur për shkak të një ristrukturimi të qeverisë kjo ministri u shkri. Aktualisht, institucioni që mbikëqyr dhe mbështet proceset e konsultimit publik në nivel qeverisjeje qendrore është Kryeministria. Ndryshime të tilla dhe rolet përkatëse për çdo institucion zbatues nuk janë pasqyruar në kuadrin ligjor. Ky kuadër duhet të përditësohet për të siguruar monitorim dhe raportim të qëndrueshëm për proceset e konsultimit publik në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Ligji përcakton detyrimin e institucioneve publike për hartimin dhe publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Të dhënat që kërkohet të publikohen janë të natyrës statistikore, prandaj nuk japin një pasqyrë të plotë të llogaridhënies institucionale për vendimmarrjen. P.sh., raporti jep numrin e rekomandimeve dhe të komenteve të marra, të pranuar dhe të refuzuara, por nuk kërkohet të japë arsyetimin për një refuzim të tillë. Raporti jep numrin e dokumenteve të miratuara nga institucioni në vitin e caktuar, por nuk i kërkohet të paraqesë numrin e dokumenteve të konsultuara, numrin e dokumenteve të pakonsultuara dhe arsyetimin e mung-

esës së konsultimit për këto të fundit. Në mënyrë që këto raporte të sigurojnë llogaridhënie të plotë, ato duhet të përmirësohen dhe të përmbajnë informacion më cilësor. Përveç nevojës për të përmirësuar përmbajtjen e këtyre raporteve, me rëndësi të madhe për garantimin e transparencës është edhe publikimi i tyre i vazhdueshëm. Vihet re se raporte të tilla mungojnë në shumicën dërrmuese të programeve të transparencës së institucioneve publike, teksa shumica e institucioneve i kanë të publikuara vetëm në regjistrin elektronik. Publikimi i tyre në regjistrin elektronik për konsultime publike është minimumi i mundshëm, por jo i mjaftueshëm, pasi shpeshherë është shumë më i thjeshtë aksesimi i një informacioni të tillë në faqet e internetit të institucioneve, sesa kërkimi në regjistrin elektronik, përdorimi i të cilit nga publiku mbetet gjithsesi i kufizuar.⁹ Transparenca proaktive dhe e vazhdueshme është një detyrim ligjor i institucioneve publike që buron nga ligji për të drejtën e informimit dhe është me shumë rëndësi për rritjen e mundësive për pjesëmarrjen e publikut në procesin e konsultimit. Shqetësime në lidhje me konsistencën dhe cilësinë e raportimit dhe monitorimit mbi këto procese janë evidentuar edhe gjatë viteve 2019-2020 nga Monitorimi i Reformës në Administratën Publike në Shqipëri, duke treguar një problem të vazhdueshëm në këtë drejtim.

Kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vazhdimësi "Komisioneri") për trajtimin e ankesave për shkelje në konsultimet publike janë të kufizuara. Ndryshe nga ligjet "homologe" (Ligji Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr. 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") nën përgjegjësinë e të njëjtit Komisioner, Ligji "Për njoftimin dhe konsultimin publik" nuk parashikon që Komisioneri të ketë autoritetin për të vendosur sanksione administrative (gjyba) ndaj personit ose institucionit përgjegjës për shkeljen. Gjithashtu, Komisioneri nuk ka mandat për të nisur hetim administrativ me iniciativën e tij (kryesisht) pa u vënë në lëvizje me kërkesë. Mandati i Komisionerit është i kufizuar edhe në kohë, duke lejuar veprimin vetëm pas miratimit të aktit objekt ankimi. Për më tepër, ligji nuk parashikon të drejtën e ngritjes së një padie për shkelje të konsultimit publik. Edhe pse mund të bëhet referencë në Kushtetutë dhe Kodin e Procedurave Administrative për pretendimin e kësaj të drejte në gjykatë, rregullimi i qartë i saj në ligj do të bënte të mundur sqarimin e procedurave dhe afateve përkatëse, veçanërisht në rastet kur nuk ka një vendim të marrë nga Komisioneri për rastin e dhënë.¹⁰ Mangësi të tilla dekurajojnë kërkesën e llogarisë, siç dëshmohet edhe nga numri i papërfillshëm i ankesave të paraqitura ndër vite.

Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, Nr. 3/2021, "Për miratimin e udhëzimeve për proceset e konsultimeve publike"

Kohët e fundit është bërë një përpjekje për të rregulluar më mirë procesin e konsultimit publik në nivel qeverisjeje qendrore nëpërmjet miratimit të udhëzimeve për proceset e konsultimit publik, me anë të një urdhri të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të miratuar në janar të vitit 2021 (në vazhdimësi "urdhri"). Ky urdhër trajton të gjitha fazat e proceseve të konsultimit publik, detyrimet për monitorim dhe raportim nga institucionet zbatuese dhe jep udhëzime e formate që duhet të përdoren gjatë planifikimit, zbatimit dhe raportimit të konsultimeve publike. Megjithatë, ky dokument është i një natyre soft law dhe fuqia e tij detyruese ndaj ministrave dhe institucioneve të tjera nën varësinë e Kryeministrit është e diskutueshme, sepse Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave nuk ka kompetencë të nxjerrë urdhra, sipas Ligjit Nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Në mënyrë që dispozitat e këtij urdhri të jenë detyruese, ato duhet të bëhen pjesë e kuadrit ligjor për të plotësuar kështu edhe disa nga mangësitë e identifikuara më sipër, si dhe për të siguruar pasjen e fuqisë juridike mbi

Funksionet dhe detyrat e institucioneve që mbikëqyrin dhe zbatojnë proceset e konsultimeve publike duhet të përcaktohen qartë në ligj për të siguruar raportim dhe monitorim të rregullt.

ministratë, institucionet në varësi të Kryeministrit si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat edhe pse nuk janë në fokus të këtij punimi, janë ndër institucionet që mbartin detyrimin për zbatimin e Ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Së fundi, për të siguruar njohjen dhe zbatimin e tyre, është e rëndësishme që udhëzimet e përcaktuara në urdhër të jenë të aksesueshme për publikun, ndërkohë që institucionet zbatuese duhet të trajtohen për zbatimin efikas të tyre.

Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 828/2015 "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrin elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike"

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 828/2015 rendit dokumentet që duhet të publikohen në regjistrin elektronik si projekt-akte për konsultim, njoftimet për konsultimet publike, planet vjetore për proceset e vendimmarrjes, informacioni për procesin e konsultimeve publike, komentet dhe rekomandimet etj., por nuk kërkon publikimin në regjistrin elektronik të arsytimit për refuzimin e komenteve dhe rekomandimeve të marra. Një informacion i tillë është me interes për aktorët që kanë dhënë kontribut, por edhe për publikun e gjerë, si dhe tregon konsideratë dhe llogaridhënie nga ana e institucioneve.

Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 584/2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave"

Rregullorja e Këshillit të Ministrave përcakton se projekt-aktet e një rëndësie të veçantë që shqyrtohen për miratim nga Këshilli i Ministrave mund të diskutohen me përfaqësues të OJQ-ve dhe aktorë të tjerë të interesuar, pa përcaktuar qartë se si duhet bërë vlerësimi i rëndësisë së dokumenteve. Dispozita të tilla të paqarta mund të keqinterpretohen dhe kanë potencialin të anashkalojnë procesin e konsultimit.

Rregullorja përcakton se relacioni shpjegues që i bashkëngjitet projekt-akteve që janë objekt konsultimi duhet të përmbajë informacione

për procesin e njoftimit dhe konsultimit. Megjithatë, kjo rregullore nuk përcakton se cilat projekt-akte për shqyrtim në KM duhet t'i nënshtrohen konsultimeve dhe as nuk kërkon relacion shpjegues bashkëngjitur projekt-akteve që nuk i janë nënshtruar konsultimeve publike, për të dhënë arsyetimin për konsiderimin e konsultimit publik si të panevojshëm. Rregullorja nuk parashikon masa që mund të merren kur një projekt-akt dorëzohet pa relacionin shpjegues për proceset e konsultimit publik, ndryshe nga rastet kur relacionit shpjegues i mungon tabela e përputhshmërisë me acquis të BE-së, për të cilën rregullorja kërkon që projekt-akti t'i kthehet institucionit propozues për të plotësuar dokumentin. Rregullorja shkon edhe më tej në rastet kur projekt-akti synon harmonizimin me legjislacionin e BE-së, duke përcaktuar se KM nuk shqyrton asnjë projekt-akt pa marrë paraprakisht mendimin e ministrit përgjegjës për procesin e integritimit në BE. Nga ana tjetër, për rastet kur shmangen konsultimet, nuk parashikohen masa që pengojnë miratimin e aktit nga KM, duke pamundësuar kështu kërkesën e llogarisë në rastet kur institucionet i shmangin konsultimet publike në mënyrë të pajustificuar.

Për sa i përket projekt-akteve që synojnë harmonizimin me legjislacionin e BE-së, rregullorja e konsideron opsionale dhënien e informacionit (në relacionin shpjegues bashkëlidhur projekt-aktit) për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e konsultimit, pavarësisht rolit të rëndësishëm që kanë organizatat e shoqërisë civile në procese të tilla, sipas politikës së vetë qeverisë¹¹. Për më tepër, rregullorja përcakton se përshkrimi i hapave të ndërmarrë për hartimin e projekt-aktit (pjesë e relacionit shpjegues bashkëngjitur këtij projekt-akti), mund të përfshijë informacione për ekspertizën e jashtme të marrë, vendase ose të huaj, nëse rekomandohet nga donatorët dhe kur konsiderohet e nevojshme. Dispozita të tilla të paqarta nuk garantojnë transparencë të plotë për përfshirjen e shoqërisë civile në konsultimet e projekt-akteve që synojnë harmonizimin me legjislacionin e BE-së.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Të rishikohet kuadri ligjor për të adresuar mangësitë që mundësojnë anashkalimin e proceseve të konsultimit publik.

Mangësitë në kuadrin ligjor dhe dispozitat e paqarta ose të përgjithshme duhen adresuar, pasi ato mund të keqinterpretohen për të anashkaluar proceset e konsultimeve publike ose të lejojnë që procesi të jetë artificial dhe i paefektshëm. Objekti i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik duhet të zgjerohet për të përfshirë edhe Vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe të parashikojë dispozita të qarta që përcaktojnë se kur janë të detyrueshme konsultimet publike; kërkesat për arsyetim objektiv për rastet kur nuk bëhen konsultime publike; rastet kur duhet të zhvillohen konsultime paraprake; afatin për dhënien e përgjigjive ndaj komenteve dhe rekomandimeve; dhe kriteret për përcaktimin e metodës më të përshtatshme të konsultimit rast pas rasti. Në kuadrin ligjor mund të përfshihen dispozitat e urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të KM me qëllim adresimin e disa prej mangësive dhe sigurimin e fuqisë juridike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Të përcaktohen qartë funksionet dhe detyrat e institucioneve që mbikëqyrin dhe zbatojnë proceset e konsultimeve publike për të siguruar raportim dhe monitorim të rregullt.

Mungesa e detyrimeve të qarta të institucioneve mund të ndikojë në monitorimin dhe raportimin e tyre për zbatimin e konsultimeve publike, duke dëmtuar llogaridhënien institucionale dhe duke kufizuar mundësitë për kontroll nga publiku apo mundësitë për reflektim për përmirësime të mundshme. Ligji dhe aktet nënligjore përkatëse duhet të rishikohen dhe përditësohen me qëllim përcaktimin qartë të institucioneve të ngarkuara me monitorimin dhe raportimin e konsultimeve publike, funksionet dhe detyrat e tyre. Po ashtu, për përmirësimin e këtyre proceseve, duhet të rishikohen kërkesat e ligjit për sa i përket përmbajtjes së raporteve vjetore të transparencës në vendimarrje për të përfshirë të dhëna cilësore për proceset e konsultimit. Së fundi, planet vjetore, raportet, si dhe të gjitha kategoritë e tjera të informacionit në lidhje me proceset e konsultimit publik duhet të përditësohen dhe publikohen në programet e transparencës së institucioneve, sipas Urdhrit Nr. 187/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në regjistrin elektronik për konsultimet publike.

Të garantohen mekanizma efektivë të ankimit për të siguruar llogaridhënie për shkeljet në proceset e konsultimit publik.

Mekanizmat e paefektshëm të ankimit bëjnë që shoqëria civile dhe publiku i gjerë të dekurajohen për përdorimin e mjeteve të tilla në rastet kur ndodhin shkelje në procesin e konsultimit publik. Ligji duhet rishikuar për të forcuar autoritetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për të garantuar llogaridhënie për shkeljet në lidhje me proceset e konsultimit publik, përveç rekomandimeve, Komisionerit duhet t'i jepet autoriteti për të vendosur sanksione administrative, për të filluar hetime administrative me iniciativë dhe jo vetëm pas miratimit të aktit objekt ankimi. Së fundi, ligji duhet të parashikojë shprehimisht të drejtën e ankimit në gjykatë për shkelje të së drejtës për konsultim publik, duke përcaktuar hapat dhe afatet procedurale.

1. Raportet vjetore të Kuvendit të Shqipërisë <https://www.parlament.al/RaporteStatistika?statusId=1>
2. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Instituti Kombëtar për Demokraci (NDI), Gjetjet e Sondazhit të Angazhimit Politik në Shqipëri, 2020 <https://idmalbania.org/survey-of-political-engagement-in-albania-2020/>
3. Leonie Vrugtman, Marsela Dauti, Besimi në Qeverisje, 2020 <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>
4. Partnerët Shqipëri, Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile – raportet për Shqipërinë 2019 dhe 2020: <https://partnersalbania.org/publication/matrica-e-monitorimit-mbi-mjedisin-mundesues-per-zhvillimin-e-shoqerise-civile-raporti-per-shqiperine-2020/>
5. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Monitorimi i Reformës në Administratën Publike 2019/2020, 2021, https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/WeBER2.0_Monitorimi-RAP-Shqiperi_2019-2020_ed.pdf
6. Blerjana Bino, Redion Qirjazi dhe Alban Dafa, Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri, 2020 <https://idmalbania.org/report-cso-participation-in-decision-making-in-albania/>
7. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Monitorimi i Reformës në Administratën Publike 2019/2020, 2021, https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/WeBER2.0_Monitorimi-RAP-Shqiperi_2019-2020_ed.pdf
8. Po aty.
9. Leonie Vrugtman, Marsela Dauti, Besimi në qeverisje, 2020 <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2020-EN.pdf>
10. Res Publica Komentari i ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", 2017 <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2017/11/Res-Publica-Komentari-i-ligjit-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 539/2019, "Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën e qeverisë drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023". <http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar.pdf>

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e Hanns Seidel Stiftung, zyra e Tiranës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Hanns Seidel Stiftung.

Për më shumë informacion, vizitoni:
www.par-monitor.org



Projekti koordinator



institut alternativa

